



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulturu, Omladine i Sport-Ministry of Culture, Youth and Sports

DATË/A:	17.03.2022
PËR/ZA/TO:	Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm z. Bislim Bislimi
NGA/OD/FROM:	Feim Hoxha, Drejtor i Departamentit Ligjor Mehdi Uka, Udhëheqës i Divizionit për Zbatim të Legjislacionit Ramiz Shala, Zyrtar i Lartë Ligjor për Sport
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion ligjor lidhur me kërkesën e Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm z. Bislim Bislimi të dërguar përmes emailit të datës 16.03.2022

I nderuar Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm z. Bislim,

Departamenti Ligjor në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 16.03.2022 ka pranuar emailin nga ju me kërkesë për dhënien e opinionit ligjor lidhur me Federatën e Futbollit të Kosovës, lidhur me pyetjen si ne vijim:

“Federata e Futbollit të Kosovës, me rastin e shpalljes së datës së mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të FFK –së, a i ka respektuar në tërësi dispozitat e Statutit të Federatës si dhe ky veprim i tyre a ka cenuar ndonjë dispozitë të Ligjit për Sport ose akteve nënligjore të tij”

Departamenti Ligjor, bazuar në Rregulloren Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe kërkesës suaj dërguar përmes emailit të datës 16.03.2022, lidhur me çështjen e ngritur ka shqyrtuar legjislacionin primar dhe sekondar si në vijim:

- Ligjin Nr. 2003/24 për Sport;
- Ligji Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive;
- Statutin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Në vazhdim po i paraqesim disa nga dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 2003/24 për Sport sipas të cilave rrjedhin obligimet reciproke të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Organizatave, përkatësisht Federatave sportive.

Në nenin 8 paragrafi 8.3:

Me shkeljen e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga aktet e tyre normative dhe nga ky Ligj, organizatat sportive dhe të gjithë subjektet e tjerë të sportit, përgjigjen para organeve të caktuara kompetente.

Në kapitullin e VI ku flitet për Federatat Sportive, përkatësisht në nenin 27 parashihet si në vijim:

Federatat e sportit, themelohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji, Statuteve dhe të rregulloreve të tyre të brendshme, të nxjerra në përputhje me këtë Ligj, si dhe të përshtatur me statutet e federatave ndërkombëtare përkatëse të sportit.

Në nenin 29 paragrafi 29.2 parashihet si në vijim:

Ministria përkatëse do të mbikëqyrë politikat sportive të Kosovës, të realizuara nga Federatat e Sportit.

Në nenin 30 paragrafi 30.1 parashihet si në vijim:

Federatat e sportit, janë të detyruara t'i publikojnë vendimet e tyre.

Gjithashtu në paragrafin 30.4 të këtij neni parashihet si në vijim:

Po qe se, vendimet e Federatave të Sportit janë në kundërshtim të hapur me aktet normative të tyre dhe me këtë Ligj, atëherë organet përfaqësuese dhe personat përgjegjës, dalin para organeve kompetente të drejtësisë, të cilat mund ta anulojnë zbatimin e vendimeve dhe të marrin masa përkatëse ndaj personave udhëheqës.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport, po i paraqesim disa nga dispozitat ligjore të cilat rregullojnë obligimet reciproke të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Organizatave sportive.

Në nenin 1 të këtij ligji parashihet si në vijim:

Me këtë ligj rregullohet organizimi, kushtet dhe mënyrat e zhvillimit të veprimtarive sportive, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të tyre, garat sportive, financimi, mbikëqyrja si dhe çështjet e tjera me rëndësi për këto veprimtari, veçanërisht themelimi, regjistrimi dhe menaxhimi i organizatave sportive.

Neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

33.1. Federatat e Sportit veprojnë mbi bazën e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

1. Neni 50 i ligjit bazik paragrafi 50.1. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

50.1. Ministria përkatëse për Sport, në mënyrë të veçantë mbikëqyrë: - përmbushjen e kushteve për realizimin e interesit publik me rëndësi për sportin kosovar.

Neni 83 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

83.1. Ministria përkatëse për Sport bën mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit për Sport Nr: 2003/24 dhe të këtij ligji.

Pas shqyrtimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive, në vazhdim po i paraqesim disa nga dispozitat e këtij udhëzimi të cilat rregullojnë çështje të rëndësishme të themelimit dhe funksionimit të federatave sportive.

Në nenin 5 paragrafi 2 të këtij Udhëzimi parashihet si në vijim:

Statuti i Federatës duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Sport dhe njëkohësisht parashihet që aktet e veçanta të cilat i nxjerrin Federatat sportive duhet të jenë në harmoni me Ligjin e Sportit, Aktet nënligjore dhe Statutin e Federatës.

Në nenin 9 paragrafi 2 të këtij udhëzimi parashihet si në vijim:

Personi/at i cili e përfaqëson federatën e Sportit, kujdesen për ligjshmërinë e punës së saj.

Në nenin 10 të këtij udhëzimi parashihet si në vijim:

Federata e Sportit duhet të ketë organet udhëheqëse në përputhje me statutin.

Në nenin 11 paragrafi 1 të këtij udhëzimi parashihet si në vijim:

Organi më i lart i Federatës së sportit është Kuvendi.

Në nenin 18 i këtij udhëzimi parashihet si në vijim:

Federata e Sportit e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin e Sportit, Aktet nënligjore, rregullat tjera normative të Federatave Ndërkombëtare të sportit përkatës dhe Komitetin Olimpik të Kosovës.

Në nenin 20 paragrafi 2 i këtij udhëzimi parashihet si në vijim:

Federata është e obliguar që organit kompetent të Ministrisë t'ia dërgojë nga një kopje të vendimeve në afatin prej 15 ditë të punës për të cilat Departamenti mbanë evidencë të veçantë.

Në vazhdim po i paraqesim dispozitat e Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Në nenin 28 Kushtet për thirrje, propozimi i anëtarëve dhe kandidatëve

1. Kuvendin e rregullt e konvokon Sekretari gjeneral në bazë të vendimit të Komitetit Ekzekutiv.
2. Sekretari gjeneral duhet t'i njoftojnë delegatët për mbajtjen e mbledhjes, 30 ditë përpara.
3. Sekretari gjeneral i dërgon thirrjet delegatëve, duke precizuar vendin, datën, kohën dhe rendin e ditës të propozuar, së paku 10 ditë para datës së mbledhjes.
4. Delegatët mund ti deponojnë në formë të shkruar propozimet për rend të ditës së paku 20 ditë para datës së mbledhjes.
5. Për Kuvendin zgjedhor delegatët mund të propozojnë kandidatët e tyre për zgjedhje në organet statutare të FFK-së, së paku 20 ditë para Kuvendit.

Neni 39 Kushtet për zgjedhjen e Kryetarit

1. Kryetari zgjedhet në Kuvendin e FFK-së, për periudhë katërvjeçare dhe mandati i tij fillon menjëherë pas përfundimit të Kuvendit i cili e ka zgjedhur. Kryetari mund të zgjedhet më së shumti tri mandate (klauzola nuk ka efekt retroaktiv).
2. Kryetar i FFK-së zgjedhet ai kandidat i cili në rrethin e parë fiton 2/3 e votave valide të Kuvendarëve prezent në rrethin e parë të zgjedhjeve. Nëse asnjëri kandidat nuk e ka numrin e mjaftueshëm të votave atëherë vetëm dy kandidatët me më së shumti vota hyjnë në raundin e dytë, ndërsa kandidatët tjerë eliminohen. Në këtë rast kandidati i cili fiton më shumë vota valide, zgjedhet Kryetar i FFK-së.
3. Vetëm anëtarët e FFK-së mund të propozojnë kandidatin për Kryetar të FFK-së. Propozuesi duhet të protokolojë propozimin në Sekretariatit Gjeneral të FFK-së, në formë të shkruar dhe duke i deponuar së paku 15, nënshkrime të delegatëve legjitim të Kuvendit të FFK-së, me të dhënat e nevojshme, së paku dy muaj para datës së mbajtjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor. Poashtu duhet të parashtrohet programi i punës. Sekretariati i përgjithshëm duhet që t'i notifikojë kandidatët për kryetar të FFK-së, së paku një muaj para mbajtjes së Kuvendit.
4. Nuk mund të kandidohen për kryetarë dhe anëtarë të KE-së, personat që janë apo kanë qenë në pozita ekzekutive, politike dhe ligjvënëse në Institucionet e Republikës së Kosovës, së paku dy vitet e fundit.

Përfundimi:

Departamenti ligjor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit pas shqyrtimit të legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e sportit, dispozitat e të cilit janë të shprehura më lartë dhe në referencë të pyetjes suaj të bërë përmes emailit me datën 16.03.2022

“Federata e Futbollit të Kosovës, me rastin e shpalljes së datës së mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të FFK –së, a i ka respektuar në tërësi dispozitat e Statutit të Federatës si dhe ky veprim i tyre a ka cenuar ndonjë dispozitë të Ligjit për Sport ose akteve nënligjore të tij”

Ndërlidhur me pyetjen tuaj të cekur më lartë, kemi shqyrtuar Aktin themeltar më të lartë juridik të Federatës së Futbollit të Kosovës – **STATUTIN**.

Me rastin e shpalljes së datës së mbajtjes së Kuvendit zgjedhor të FFK-së, bazuar në dispozitat statutare të cilat burojnë nga Ligji për Sport, përkatësisht **neni 30 paragrafi 30.1** Federatat e sportit, janë të detyruara t'i publikojnë vendimet e tyre. Me këtë rast evidentohet se Federata e Futbollit të Kosovës nuk e ka bërë publik Vendimin për thirrjen e Kuvendit zgjedhor. Në kuptim të kësaj norme Federata përkatëse nuk e ka respektuar Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive, përkatësisht nenin 18 i cili parasheh që Federata e Sportit e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin e Sportit, Aktet nënligjore, rregullat tjera normative të Federatave Ndërkombëtare të sportit përkatës dhe Komitetin Olimpik të Kosovës, gjithashtu në kuptim të nenit 30 pika 1 të Ligjit bazik për Sport Nr. 2003/24, nenit 9 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive, i cili parasheh që personi i cili e përfaqëson Federatën e Sportit kujdeset për ligjshmërinë e punës së saj, si dhe nenin 20 paragrafi 2 të këtij Udhëzimi i cili parasheh që Federata është e obliguar që organit kompetent të Ministrisë të i'a dërgoj nga një kopje të vendimeve në afat prej 15 ditëve të punës për të cilat Departamenti mban evidencë të veçantë.

Në kuptim të kësaj, Federata e Futbollit të Kosovës nuk ka respektuar dispozitat e cekura më lartë të Ligjit Nr. 2003/24 si dhe të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive.

Në kuptim të **kapitullit të VI të Ligjit bazik për Sport Nr. 2003/24 ku flitet për Federatat Sportive, përkatësisht në nenin 27 parashihet:**

Federatat e sportit, themelohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji, statuteve dhe të rregulloreve të tyre të brendshme, të nxjerra në përputhje me këtë Ligj, si dhe të përshtatur me statutet e federatave ndërkombëtare përkatëse të sportit.

Ndërlidhur me këtë, referenca e nenit 28 të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës aplikohet në rastet kur thirret Kuvendi i rregullt i punës së Federatës siç është përcaktuar

në nenin 11 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive i cili parasheh:
Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të punës duhet të mbahen së paku një herë në vit.

Poashtu bazuar në Ligji Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport, neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim: Federatat e Sportit veprojnë në bazë të këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi, neni 50 i ligjit bazik paragrafi 50.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim paragrafi 50.1, Ministria përkatëse për Sport në mënyrë të veçantë mbikëqyrë përmbushjen e kushteve për realizimin e interesit publik me rëndësi për sportin kosovar, si dhe neni 83 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim i cili parasheh që Ministria përkatëse për Sport bënë mbikëqyrjen e zbatueshmerisë të Ligjit për sport Nr. 2003/24 dhe të këtij ligji.

Në kuptim të kësaj konsiderojmë se Federata e Futbollit të Kosovës nuk i ka respektuar në tersi dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e sportit.

Gjithashtu në Ligjin bazik për Sport Nr. 2003/24, përkatësisht paragrafin 30.4 të këtij neni parashihet si në vijim:

Po qe se, vendimet e Federatave të Sportit janë në kundërshtim të hapur me aktet normative të tyre dhe me këtë Ligj, atëherë organet përfaqësuese dhe personat përgjegjës, dalin para organeve kompetente të drejtësisë, të cilat mund ta anulojnë zbatimin e vendimeve dhe të marrin masa përkatëse ndaj personave udhëheqës.

Njëkohësisht bazuar në pyetjen tuaj se “Federata e Futbollit të Kosovës, me rastin e shpalljes së datës së mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të FFK –së, a i ka respektuar në tërësi dispozitat e Statutit të Federatës”

Duke pasur parasysh që me hyrjen në fuqi të Ligjit bazik për Sport dhe Plotësim ndryshimit të tij, të gjitha Federatat Sportive janë obliguar që statutet e tyre ti harmonizojnë me dispozitat e legjislacionit të sportit.

Në kuptim të kësaj dhe lidhur me pyetjen tuaj si dhe mbështetur në legjislacionin primar dhe sekondar për sport ndërlidhur me Statutin e Federatës së Futbollit të Kosovë i cili në nenin 39 parasheh kushtet për zgjedhjen e Kryetarit, përkatësisht paragrafi 1 dhe 3 i këtij neni ku shprehimisht thuhet:

“Kryetari zgjedhet në Kuvendin e FFK-së, për periudhë katërvjeçare dhe mandati i tij fillon menjëherë pas përfundimit të Kuvendit i cili e ka zgjedhur. Kryetari mund të zgjedhet më së shumti tri mandate (klauzola nuk ka efekt retroaktiv)”

Në kuptim të paragrafit 1 të nenit 39 të Statutit të Federatës së Futbollit, konsiderojmë që kjo Federatë ka Kryetar të zgjedhur ku mandati i tij nuk është përmbushur siç parashihet në këtë paragraf dhe shpallja zgjedhjeve në datën e specifikuar edhe për një mandat të ri pa e përfunduar mandatin ekzistues nuk është në pajtueshmëri me këtë paragraf.

Në kuptim të paragrafit 3 të nenit 39 të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës ku shprehimisht thuhet:

“Vetëm anëtarët e FFK-së mund të propozojnë kandidatin për Kryetar të FFK-së. Propozuesi duhet të protokollojë propozimin në Sekretariatit Gjeneral të FFK-së, në formë të shkruar dhe duke i deponuar së paku 15 nënshkrime të delegatëve legjitim të Kuvendit të FFK-së, me të dhënat e nevojshme, së paku dy muaj para datës së mbajtjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor. Poashtu duhet të parashtrohet programi i punës. Sekretariati i përgjithshëm duhet që t’i notifikojë kandidatët për kryetar të FFK-së, së paku një muaj para mbajtjes së Kuvendit”

Në kuptim të paragrafit 3 të nenit 39 të Statutit të Federatës së Futbollit, konsiderojmë që kjo Federatë nuk e ka zbatuar paragrafin 3 të këtij neni ku shprehimisht përcaktohen afatet kohore për organizimin e zgjedhjeve për Kryetar në Federatën e Futbollit të Kosovës.

Me respekt,

